



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1033/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Nartel Design”, me NRB:..., me seli në Prishtinë Rr. “Agim Ramadani” nr.22/49, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “S. P.” Sh.p.k., me seli në Prishtinë, Soliteri Avalla P+12, kundër debitorit KCSF- Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, me NRB: ..., me seli në Prishtinë Rr.”Fazli Grajçevci” nr.4/a, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “S. & Q.” Sh.p.k., me seli në Lagjen “Veternik” Kompleksi EXDC3, Blloku 10, Kati 6, nr.17 duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.2054/17 të datës 05.12.2017, të Përmbartuesit Privat Eset Murati nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 27.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit KCSF- Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, me seli në Prishtinë, i paraqitur kund Urdhrit Përmbartimor P.nr.2054/17 të datës 05.12.2017, të Përmbartuesit Privat Eset Murat me seli në Prishtinë.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.2054/17 të datës 05.12.2017, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Nartel Design”, me NRB:..., me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.2054/17 të datës 05.12.2017, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës me numër 30081701 të datës 30.08.2017, me të cilën e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të mbetur nga fatura e lartcekur shumë prej 41,600.00 €, me kamatë prej 8% në vit duke filluar nga data e rënies në vonesë 01.09.2017, e deri në pagesën definitive të borxhit

si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se debitori nuk obligohet për përmbushjen e detyrimit prej 41,600.00 euro, sepse lidhur me diferencën ka bërë kompensimin e kërkesave, sipas para kontratës lidhur me shitblerjen e lokalit afarist, pasi që kishin të bënin me dorëzimin e lokalit, e që debitori ishte detyruar që të paguaj qira shtesë për shkak të pamundësisë së hyrjes në lokal. Më tutje, ka shtuar se debitori ka theksuar se lidhur me faturën e dorëzuar është duke u zhvilluar procedura e arbitrazhit e cila ka kompetencë ekskluzive për të shqyrtuar këtë çështje. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përbarimor si dhe të obligohet kreditori ti paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore dhe gjyqësore.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në prapësim si të pabazuara, ngase çështja në rastin konkret është procedurë e në bazë të dokumentit të besueshëm dhe është i mbështetur në nenin 29 të LPP-së. Më tutje ka theksuar se fatura provon faktin për kryerjen e punëve të caktuara dhe përmbushjen e detyrimit kontaktues të njëjës palë dhe detyrimin e palës tjetër që të bëjë pagesën për punët e kryera. Ka shtuar se fatura mund të kundërshtohet në formë të shkruar për punët konkrete të pa kryera eventualisht apo të kryera jo si duhet, ndërsa në rastin konkret fatura nuk është kundërshtuar fare, e në rastin konkret pretendimet janë të natyrës kontestimore e jo përbarimore. I ka propozuar gjykatës që prapësimi debitorit të refuzohet si i pa bazuar dhe të aprovoj urdhërin përbarimor si të bazuar.

Gjykata në ri procedurë duke vepruar sipas sugjerimeve dhe vërejtjeve të Gjykatës së Apelit sipas vendimit AC.nr.4647/20 të datës 08.06.2021, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pa bazuar, andaj, të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerësoi se urdhri P.nr.2054/17 të datës 05.12.2017, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore për shkak se në këtë rast Përmbartuesi Privat e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme, përkatësisht faturës, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata konstaton se në këtë çështje përmbartimore urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentet e besueshme përkatësisht faturën me numër 30081701 të datës 30.08.2017, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, ngase në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përcaktuara mallrat/shërbimet të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Në rastin konkret rezulton se fatura është dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, lidhur me pranimin e faturës nga ana e debitorit vërtetohet edhe nga deklarata e lëshuar nga debitori e datës 31.08.2017, si dhe fakti se fatura është paguar pjesërisht dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga ana e debitorit.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim sa i përket mos pagesës së pjesës së mbetur sipas faturës për shkak të kompensimit të kërkesave sipas kontratës mbi shitë-blerjen, për shkak të vonës në dorëzim të objektit, që në fakte nuk ishte penallti por thjeshtë zhdëmtim i kontraktuar për qiranë shtesë që debitori u detyrua të paguaj, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë

nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarimore.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1033/22, datë 27.11.2023

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.